



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 25, datë 28.02.2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 85, DATË 03.07.2017 “MBI LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË VLERËSUESIT TË DËMEVE NË SIGURIME”, E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR**  
**Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin METE**

**Në Rregulloren nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:**

1. Neni 4, pika 2, ndryshon si vijon:

*“2. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkuesin për miratim/licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.”*

2. Neni 16, ndryshon si vijon:

*“Procedurat e licencimit*

- 1. Autoriteti shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur për licencim. Autoriteti nëse vëren mangësi apo pasaktësi në dokumentacionin e paraqitur, apo nëse e gjykon të nevojshme, njofton kërkuesin për licencim për plotësimin e tyre brenda një afati 30 ditor. Ky afat mund të zgjatet edhe me 30 ditë të tjera për arsye të justifikuara. Nëse pas përfundimit të afatit, nuk plotësohet dokumentacioni, shqyrtimi i kërkesës/aplikimit ndërpritet. Në rast riaplikimi, dokumentacioni duhet të depozitohet nga e para.*
- 2. Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë nga ana e kërkuesit për licencë, jep licencën për ushtrim veprimtarie në vlerësimin e dëmeve.*
- 3. Licenca është me afat të pacaktuar.”*